



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

Adresa: Bashkia Kolonje "Sheshi Rilindja"7401 Erseke, Kolonje Albania, Web: www.kolonja.gov.al, Email : info@kolonja.gov.al

PROCESVERBALI I TAKIMIT DATE: 22 SHTATOR 2022

VENDI: Fshati Selenice, Shkolla "Jonuz Gara " dhe ne fshatin Qinam

ORA: 12:00

Tema e Konsultimit: Mbledhja e Rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per hartimin e buxhetit per vitin 2023.

Baza Ligjore: Ne mbeshtetje dhe ne zbatim te Ligjit Nr.146/2014 "Per njoftimin dhe Konsultimin Publik" neni 11 pika 2, Ligji Nr. 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore " neni 34, Ligjit Nr.68 /2017 "Per financat e veteqerisjes vendore", ligjit nr.9936, date 26.06.2088, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar,ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Pjesemarres: Kryetari i Bashkise Z.Erion Isai, Sekretarja e Pergjithshme Znj. Sofika Rrexhepi, Drejtori Ekzekutiv /INFOCIP (Qendra per Ceshtjet e Informimit Publik), Rreth 40 banore ne fshatin Selenice dhe 35 banore ne fshatin Qinam.

Fjalën e hapjes së takimit e mbajti Kryetari i Bashkisë, i cili pasi u shpjegoi banorëve arsyen e takimit, falenderoi për bashkëpunimin e ndërsjellë të institucionit dhe banorëve përsa i përket ndërtimin të ujësjellsit, i cili u shtri ne 23 fshatra dhe e konsideroi si rast model.

Z.Isai informoi se punimet në ndërtimin e rrugës Korçe – Ersekë janë duke vazhduar dhe se nga infrastruktura e re do te shkurtohet distanca më tej me të dy qytetet, cka do të lehtësojë lëvizjen e njerëzve dhe shkëmbimet tregatave. **Banorët ngritën problemin e konfliktit të ujit vaditës mes Selenicës dhe Kreshovës. Kryetari u shpreh se është në dijeni të këtij problemi afatgjatë dhe janë në protje të financimit nga Ministria.**

Kryetari vazhdoi të njoftonte se në vazhdim do të ndryshojë sistemi i ndricimit të Ersekës dhe Leskovikut, duke bërë me dije se do të jetë ndricim LED, pra më cilësor dhe më pak i kushtueshëm. Gjithashtu ai njoftoi se është planifikuar të ndryshojë mënyra e menaxhimit të

mbeturinave, për të shmangur hedhjen e tyre në përrua, uji i të cilit përdoret për vaditje. Do të ketë një ditë dhe një orar të caktuar për grumbullimin e tyre.

Ndërsa Z.Isai shprehu se takimi i mbajtur nuk kishte asnjë ngjyrim politik, ai u shpreh se mirëpriste të dëgjonte të gjitha shqetësimet, kërkesat dhe sugjerimet e baorëve, së pari ato publike e më pas ato personale / individuale.

Një nga banorët e fshatit ngriti shqetësimin e tokave të përfshira në sipërfaqen e ndërtimit të rrugës Korcë – Ersekë.

Z. Isai sqaroi se aktualisht janë bërë matjet dhe të gjithë do të marrin dëmshpërblim me cmim shteteror.

Një zotëri tjetër u shpreh se cmimi i ujit është tepër i lartë.

Kryetari sqaroi se bëhet fjalë për ujë të pijshëm, i cili vjen 24 h dhe se cmimi ishte larg kostove reale të mirembajtjes.

Diskutimi nga ana e banorëve vazhdoi dhe konsistoi në këto pika :

- 1. Ne në fshat kemi më tepër kërkesa dhe nevoja për ujë, për shkak të sipërfaqeve më të mëdha apo vaditjeve në krahasim me qytetin.*
- 2. Uji i pijshëm nuk është për vaditje*
- 3. Sahatët e natës janë vendosur në mënyrë selective, disa brenda dhe disa jashtë shtëpive.*

Kryetari Z.Isai argumentoi si më poshtë:

- 1. Përsa i përket pjesës së sahatëve kjo gjë nuk është vertetë.*
- 2. Së dyti, vlera e pagesës së ujit nuk është në dorë të kryetarit të bashkisë apo ujësjellësit, uji i pijshëm nuk përdoret për vaditje dhe cmimin e tij e ka në dorë enti.*

Një tjetër banor shprehu shqetësimin se që prej kohës së pandemisë, për shkak të punimeve me kanalizimet i janë prishur 3 dynyme tokë. Ai shprehu kërkesën që të bëhën rregullimet e duhura.

Administratori sqaroi se në kohën kur janë hapur ato punime, Bashkia ka qënë nën udhëheqjen e nje kryetari tjetër. Shkak për ndërprerjen e punimeve u bë prishja e fadromës. Kryetari Z.Erion Isai e konsideroi atë një problem të vogël dhe premtoi zgjidhje.

Në këtë moment të takimit fjala ju kalua Drejtorit Ekzekutiv / INFOCIP , Z.Gerti Shella, i cili pasi prezantoi veten, projektin dhe arsyen e pjesëmarrjes në këtë konsultim, u dha banorëve një sugjerim. Duke marrë parasysh se nevojat janë të mëdha dhe burimet e kufizuara, atëherë të gjithë së bashku si fshat të diskutojmë problemet dhe të dalim me dy apo tre pika të përbashkëta, për të cilat të kërkojmë zgjidhje te kryetari.

Banori tjetër që mori fjalën u ankua për cilësinë e dobët të asfaltit që sjell përmbytje kur ka rreshje shiu.

Kryetari u përgjigj se ato punime janë realizuar në vitin 2017, nën drejtimin e një kryetari tjetër. Megjithatë qyteti i Ersekës nuk ka kanalizime të ujërave të zeza, ndërsa selenica i ka.

Kryeplaku i fshatit u bë pjesë e diskutimit duke sqaruar se kur u bënë punimet e reja para disa vitesh, tubot e fshatit mbaruan.

Kryetari Z.Isai udhëzoi se të mbahen shënime dhe premtoi se ky problem do të zgjidhej.

Banorët e fshatit vazhduan me problemin e rradhës. VKM për prerjen e lëndëve drusore është e njëjtë në të gjithë Shqipërinë dhe parashikon lejen për të filluar në datën 1 Tetor, gjë që është tepër vonë për një rajon të ftohtë si Erseka.

Kryetari sqaroi duke ju dhënë të drejtë se ky problem është diskutuar me Ministren znj.Mirela dhe po diskutohet vendimi.

Kur banorët ngritën problemin e cmimit të lartë të druve, ai bëri krahasimin me cmimin prej 76 mijë lekësh në Korçë dhe sërish janë më ekonomike. Banorët kërkuan që leja të jepet para se të fillojnë shirrat e vjeshtës.

Problemi i rradhës lidhej me distancën që kakrijuar rruga e re. Rruga aktuale ka 78 fshatra, pra midis distancës Korçë – Ersekë. Krijimi i rrugës së re do të lërë jashtë rrugës kryesore. Korca dhe Erseka na bien me larg – u shprehen banorët.

Kryetari Z.Isai u shpreh se edhe rruga aktuale distancon disa fshatra të tjerë, megjithatë rruga e re distancat i shkurton si nga Korca ashtu edhe nga Erseka.

Një tjetër banor ngriti shqetësimin për vendkalimin e kafshëve në rrugën e e, duke kërkuar të krijohej një hapësirë e posacme.

Kryetari Z.Isai shpjegoi se firma e ndërtimit ka lënë hapësira për kërkesat e banorëve. Ai udhëzoi që të takoheshin disa persona nga fshati me kryeplakun dhe inxhinierin e firmës për të diskutuar për detajet.

U rihap dhe njëherë çështja e ujit të vaditjes me Kreshovën si një shqetësim i banorëve.

Kryetari Z.Isai i sqaroi se në investimin e rradhës do të jenë dy linja të ndara – duke mbyllyr fjalën e tij dhe njëkohësisht takimin.

Pas përfundimit të takimit konsultativ me banorët e fshatit Selenicë, takimi i rradhës u zhvillua në fshatin Qinam

Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë Z.Erion Isai. Që në hyrje të fjalës së tij Z.Isai u bëri me dije banorëve se përtej ngjytimeve politike t'i flasin problemet e tyre sepse nëqoftë se nuk i flasin ato nuk do të zgjidhen – tha kryetari. Nëse ne do të presim vetëm fonde nga qeveria rradha e investimeve për në fshatin tuaj për hir të realitetit vjen pak më vonë se Erseka / Leskoviku.

Një nga banorët që mori fjalën u shpreh se problem jone është se ne “nuk bien në një mendje”. Për tej kësaj së pari ju falenderoj që na sollët ujin e pijshëm se ziheshim njëri me tjetrin. Problemi që dua të shpreh është problem lidhur me hipotekën. “Shtëpitë tona s’janë tonat”. Ju me te drejtë na kërkon taksat por nuk ofroni shërbimet. Unë kisha fëmijën për master. Nuk marr dot kredi sepse nuk kam hipoteke por kjo sdo te thotë që fëmija im të lerë masterin.

Kryetari Z. Isai: Keni shumë të drejtë, ju erdhen matjet ?

Banori u pergjigj se “ende nuk kanë ardhur për të kryer matjet, është tmerr, matja, harta, fotoe dixhitalizimi. Ai person quhet Edmond Leko, duan tender 100 mln leke. Nderkohe VKM-ja parashikon 0 leke per tokat ne bregdet, Renato erdhi në bashki për leje ndërtimi...”

Pavarësisht të gjitha theksoj dhe njëherë se duam hipotekën, faleminderit për ujin e pijshëm, dhe të jesh i vetëdijshëm që taksat i paguajme, padyshim mund te ketë dhe të tjerë që nuk i paguajnë. Shteti me taksa mbahet.

Pas gjithë diskutimeve të banorëve kryetari arriti t'u bënte me dije banorëve se ju jeni njerëz punëtorë dhe njerëzve punëtorë nuk ju bie ekonomia. Ne do të na keni të gatshëm për cdo gjë dhe do t'i realizojmë të gjitha gjerat së bashku- mbylli fjalën dhe takimin kryetari.

Hartoi dhe mbajti kete procesverbal:

Sofika Rexhepi

Sekretare e pergjithshme

Bashkia Kolonje





FOTO – GALERIA E KONSULTIMIT



Për të shikuar të plotë foto- galerinë aktivitetit klikoni linkun:

<https://konsultimivendor.al/galeri-kolonja/>